


BESNIK MUSTAJ

MOTIVE  
TË GËZUARA

AKTIVITETI  
BIBLIOTEKA  
SHKOLLOR

811-1

17198




Vjersha

814-  
1498

BESNIK  
MUSTAFAJ

# Motive Të gëzuara

vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

MUSTAFI  
BESHIK

Motive  
Të gëzuar



1978



Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

Kombinati Poligrafik Shtypshkronja e Re Tiranë, 1978



## P Ë R N Ë N Ë N

Kam muaj pa të parë, e shtrenjta ime, e urta.  
Të puthurat e tua të fundit, kur më përcolle,  
përditë m'i gicilojnë faqet, ballin, buzët.

Përditë lumi i mallit për ty  
më rrjedh më i fryrë në zemër.  
Malli për ty, në qënien time,  
më të rëndë se çdo gjë e ka peshën.

Tani kur i përkulur mbi librat e shkollës jam a mbi  
ndonjë vjershë,  
më del para sysh fytyra jote  
me të qeshurën e veçantë që ka nëna për birin në  
buzë.

Rrudhat e ballit e thinjat duket sikur m'i  
përsërisin  
fjalët që më the, kur u nisa:  
— Ardhsh i bardhë!  
Dy fjalë me dëshirën e zemrës  
brenda.

## MBRËMJA E FUNDIT

Dhamë dhe provimin e fundit të maturës.  
Nesër në karvanë të gëzueshme  
do të na shohin të udhëtojmë drejt hekurudhës.  
(Sapo i hekurosëm pantallonat, shamitë e kaltra e bluzat.)

Kjo është nata e fundit konviktore, që na mbledh  
në dhomën tonë nr. 26.

Mbi tavolinë janë akoma librat e shkollës,  
si përshëndetja e fundit e një kohe që s'do ta takojmë  
më kurrë.

I marrim ngadalë, hapim kapakët e tyre me mall,  
sikur takohemi prapë me gjithë ato ditë të bukura,  
me shqetësimet e gëzimet e tyre të shumta.

## MALET ME BLERIM MBULUAR

Me gunën e blerimit tuaj  
u mbështollëm,  
kur hasmi na i dogji të mbjellat.

Në degët e rrënjët e blerimit tuaj  
varëm jetën,  
kur na i prishën të mbjellat.

Male shqiptare,  
me blerimin e jetës mbuluar,  
nëpër shekuj,  
istikamet tuaja të gurta  
vendlindjet e vendvdekjet tona të  
përhershme.

Sot  
nëpër trajtat shkëmbore të fytyrës  
suaj të mrrolur,



pranë pozicioneve të zjarrit,  
pranë minierave, rrugëve  
automobilistike,  
pranë pemëve frutorë të tarracave,  
nëpër kullota, nëpër parqet e  
qytezave të sharrëxhinjve  
hapim toka të reja,  
dhe vigjilojmë.

## BALADA E FËMINISË

Tek po më puthte, për të më pushuar  
vajin,  
nënë ma vranë.

Qumështi i buzëve e lotët e syve  
ma mbuluan fytyrën,  
m'i mbushën grushtet,  
nënës ia derdha mbi plagë,  
po gjaku s'iu ndal.

Ma vranë nënën këmishëzinjtë.  
Flakë e syve iu rrit në sytë e mi,  
zemra e saj hyri në gjoksin tim.

Gjak i asaj zemre në shpirt e në deje  
më rrjedh, shkumëzohet e oshëtin si  
lumë.

Urrejtja për të gjithë armiqtë  
përherë në rritje pa njohur gjumë.



## MJESHTRI PLAK I URAVE

Ecën ngadalë mbi urën që ka ndërtuar vetë.

Nëpër rrudhat e ballit  
sikur i rrjedhin tërë lumenjtë e vjetër e të rinj,  
që brigjet ua lidhi me krahë të hekurt.

Gishtërinjtë i janë holluar e forcuar si ganxha,  
shpatullat formën e harqeve të urave i kanë marrë,  
nëpër to erozion i ujërave të viteve thyhet.

Në kokë flokët të bardhë, të bardhë,  
a thua se i ka mbështjellë shkuma e stërkalave.

## FYELLI

Gjashtë të çarat e tij  
gjashtë gryka malesh,  
ku rrjedhin gjashtë lumenj gjaku  
të rënësh  
nëpër shtratin e këngëve të trimërisë.

Gjashtë sytë e tij  
gjashtë liqene alpine,  
ku lahen mëngjeset  
e gjashtë muajve më të mirë  
të vitit.

Gjashtë dritaret e tij  
gjashtë zemra vajzash,  
ku buzëqeshin  
gjashtë djem të bukur punëtorë.

## RRITJA

(Qyteti B. Curri)

Moshatari im,  
fëmijëria jote — kinemaja e vogël  
me dërrasa pishe.

Në fëmijërinë tënde, fëmijëria ime  
duke parë film.

Si binjakë u rritëm.

Ëndrrat për jetën  
të bukura si veten.

Mbi supet e bukura të rritjes sonë,  
të lumturisë sonë,  
duart e Partisë.

Zëri yt  
për jetëgjatësinë e këtyre duarve —

betim.

Në zërin tënd, i shkrirë me mish e me kocka —  
zëri im.



## MOTIV I GËZUESHËM

Sa i bukur na çeli në sy ky mëngjes prilli.  
I shkundën kumbullat lulet e tyre,  
petalet rreth gushe ia bënë kurorë  
e vesën mbi qerpikë ia vunë nuses së re.  
E shtrydhi rrushi mushtin e tij  
e me të ëmbël ia lagu buzët,  
degët e gjata i përplasën arrat,  
sikur domin të na e mbanin ritmin e valles.

U derdh gazi ynë, u përplas në fyell,  
në këngë të hareshme iu ngritën stërkalat,  
daullja plasi t'i dalë sharkisë para,  
në zemrën e çiftelisë qeshin vajzat.

## NATË DHJETORI

Qielli i verbër i natës së dhjetorit  
është ulur aq poshtë, sa peshon mbi  
kokën time,  
e shiu i hollë,  
shiu i ftohtë i bjeshkëve,  
përplasat mbi faqet e mia e mbi pushkën  
time.

Syri im i pagabueshëm, tek shënjestra,  
kontrollon gjithçka që lëviz brenda horizontit  
të maleve;  
që nëpër shtëpitë e bardha t'u qeshin sytë  
fëmijëve,  
që me ajër të lirë të mbushin gjoksin këngët e  
bjeshkët,  
që kthjelltësia e Vrellës së Shoshanit të mos  
mbytet me gjak,  
që lapidarët, bustet e monumentet e të rënëve  
ta ndiejnë veten të qetë...

Sonte në këtë natë dhjetori,  
faqja ime dhe faqja e pushkës  
ngrohin njëra tjetrën.

IMPRESSION





## G Ë Z I M

Ai gjithë natën e kaloi mes dhëve të tufës së tij.  
Zëri i vogëlushit të porsalindur i vinte e i  
bashkohej me blegërimat e qingjave.

I përkëdhelte qingjat  
me dashurinë për vogëlushin që akoma s'e  
kishte parë  
e ndiente t'i gufonte zemra,  
si para faqeve të kuqe të djalit të tij.

Lumturia e koloviste në krahët e ngrohtë të  
këtë bari që sonte u bë dhe baba. saj

## BUJKESHAT MALËSORE

(Vajzave të shkollës së mesme bujqësore, Tropojë)

Copëza të bukura të peizazhit malësor,  
erdhët e mbushët korridoret e shkollës.

Nuk ke kurrsesi të mos e ndiesh gëzimin e tyre,  
nga vet mënyra se si qeshin,  
që të kujton stinën kur çelin lulet.

Tani sytë iu qeshin nënave, kur ju shtrëngojnë në  
krahë,  
buzët iu dridhen, kur ju puthin faqet-mollë.

Gëzohen ato se vajzat u rritën shtojzovalle  
bjeshkësh  
e bujkështa të mira u bënë siç i patën  
ëndërruar.



TRAKTOR ET

## NË SALLËN E TEATRIT TË OPERAS DHE BALETIT

I shoh bashkëfshataret e mia belholla e këmbëshpejta,  
sa bukur e rrotullojnë vallen edhe këtu në sallën e  
Teatrit të Operas dhe Baletit  
e bëjnë që gjithë zemrat e spektatorëve  
me ritmin e daulles së tyre të rrahin.

Zërat e tyre shkrirë në tingujt e çiftelisë e të defit,  
të pastër po aq sa edhe sytë e tyre të mëdhenj,  
gurgullojnë, mbushin sallën,

Oshëtimën e ortiqeve që copë-copë bëhen në grykën e  
Dragobisë,  
m'u duk se dëgjove.



~~74257~~  
13493

## TRAKTORËT

(Traktoristëve të SMT-së B. Curri)

Kur erdhët për herë të parë këtu në bjeshkë,  
malësia ju këndoi një këngë të vjetër lahute.

Ju i kënduat një këngë të re,  
(refrenin e jetës sonë)  
me lëmin mal mbushur duaj gruri

e misri.

Tani të parët ju e ndieni mugullimin e pranverës  
e të parët e përshëndesni ardhjen e gjelbër të saj.  
Tokës së ngopur me ujërat e bardha të borës,  
gjirin e vlagët ia mbushni me farën e drithit.

Në stinën e korjeve,  
kur kallinj të e shëndetshëm të grurit e të

misrit

mbushin hambarët;

zemra juaj e metaltë  
në zemrën e malësorit ka pjesën e saj

të gëzimit.

## ÇDO FJALË...

Çdo fjalë e saj aromë jodi ka,  
çdo fjalë e saj  
diçka nga natyrë e bregdetit më fal.

Ulen në shpirtin tim malësor  
klithma çafkash me shkumën e valëve  
në krahë,  
buzëmbremje të bronzta,  
mëngjese të kaltra  
e hëna në Jon duke u larë.

Në gjumë më vuri një këngë e vonuar  
peshkatarësh,  
në dy krahë pulëbardhash m'u përkundën  
ëndrrat

e kur u zgjova,  
një tufë stërkalash thërrmuar mbi shkëmb,  
m'u derdhën mbi sy e mbi faqe...



## ME PRILLIN QË PO VINTE

Mbrëmë tek po shkoja, për të marrë turnin  
e tretë në minierë,  
prillin që po vinte takova  
e me prillin gojarisht bisedova.

I fola për të gjithë shokët e mi  
të nëntokës,  
për iniciativat, tejkalimet e gëzimet e  
tyre të shumta,  
për dashuritë e reja e për dasmat  
për fëmijët e bukur që të katër stinëve  
qytezës sonë i japin ngjyrat e pranverës.

## EDNË BLOKUN E MOLLËVE

Për hapjen e mbjelljen e tij punuam të gjithë,  
të kujtohet?

Unë thashë se i shoh tërë lulet e këtyre pemëve,  
të pluskojnë në bukurinë e fytyrës sate,  
ti veç qeshe e shtatin tim të kenë,  
mollëve që po mbilleshin u urove.

Tani kur të dy në hijen e tyre shëtisim  
ndiejmë se dashuria e bardhë dhe e freskët  
si lulet e këtyre mollëve na mbeti.

## MBRËMJA E PARË NË JEZERCË

Mbrëmë mbi malin e Jezercës i ngritëm çadrat  
tona gjeologe.  
Muzgu malësor i çuditur e i gëzuar e mbështolli  
qytezën tonë.

Mbrëmë për së pari u njohëm me këtë tokë.  
Ajo na uroi mirëseardhjen  
duke na mbështjellë me aromë lëndinash  
e me ujë të akullt bore na gostiti.

...

Këto çadra të vogla,  
këto trokëllima çekiçësh mbi gurë,  
këto të qeshurat tona,  
janë gugatjet e para të një qyteti të  
bukur minator  
këtu mes maleve.



## ÇIKA E MALËSISË

Merrja dhe një herë, o moj të lumtë goja,  
këngëtarja jonë me shpirtin çifteli.

Erërat e malit e ndalin vrapin,  
Valbona s'i rreh brigjet, ka frikë se bën  
zhurmë

e hidhet zemra me zërin e këngës:  
«O kërce, moj çikë, moj çikë malësie...»

E lehtë si flladi kënga hap krahët,  
nëpër lulet e syve të çikave bujkështa ndalet  
e petalet ua lan me vesë të kthjellët.  
Lumturia e tyre këndon këngën e saj:  
«O se të drejtat, çikë, o na i dha Partia...»

Ushtimëmadhe si pushka kënga përhapet.  
Nëpër zemrat e burrneshave malësore hyn  
e me gojën e saj e të tyre piskat:  
«O Partisë besën ia kemi dhënë për jetë...»

Këndo, shoqe, e bardha gojë të lumtë,  
çika e malësisë me shpirtin çifteli.



## MARSHI I POEZISË SË VËRTETË

Jam këngëtarja më krenare e botës,  
i këndoj njeriut të ri të botës së re.  
Mbaj mbi vete barrën e shqetësimeve të  
kohës,  
në zemrën time e kuqe dashuria e vërtetë.

Zgjasin turinjtë izmat të më kafshojnë,  
në trupin tim të fortë u ngelen  
dhëmbët.

Jam këngëtarja më e lumtur e botës,  
komunizmi më mbush përherë me  
shëndet.

Hije poeziqkash që prej një mijë  
shekujsh  
thyhen nga pesha e hapit tim të hekurt.

## VENDI I BUKURISË

Gjithkush që rri qoftë edhe një çast këtu,  
ndien se shumë gjëra prej teje ka marrë.

Se ti, Fierzë,  
je bërë vendi i bukurisë së kumbimit,  
i të qeshurës së punëtorit  
e i lëvizjes së vrullshme të automjeteve të  
ngarkuara  
me trupin e ardhshëm të digës,  
më shumë se i bukurisë së ashpër të maleve, i qiellit  
të kaltër  
e i breglumit të zhveshur,  
ku gurzit e bardhë duken si pikat e ngurtësuar  
të lotëve  
të nënës malësore,  
që rendte flokëlëshuar anës ujërave të turbullta  
që kishin marrë kufomën e djalit të saj,  
vrrarë në gjak.

Forca e klasës  
hapësirën e kësaj luginë e shndërroi në një zgavër  
gjigante sharkie;  
nesër me tinguj dritash do na i mbushë rrugët  
e gjera  
e dhomat e shtëpive.

VERDI I BUKURISË



## P È R G J I G J E

(Një shokut, që i shkruante të atit ta  
largonte nga kantieri verior)

Veç ta shihje tët atë si u bë duke lexuar  
letrën tënde;  
zymtësia e një muzgu dimri iu shkund mbi  
fytyrë

e murrizët e shqetësimit  
iu ngulën thellë e filluan ta brejnë.

Pra, të ishte mërzitë jeta e kantierit.  
Shkëmbinjtë e këtyre fjalëve  
u rrokullisën thershëm mbi shpirtin e tij  
prej komunisti

e balta e tyre  
iu duk sikur ia nxiu plagët e marra në luftë.

I kërkoje t'i «luante miqtë» për të të tërheqë  
prapë në Tiranë.



Secila nga këto fjalë paska pasë nga një urë  
të ndezur në ballë,  
se përnjëherë  
zemërimin të tij i dhanë zjarr.

Këtë mos e prit prej tij as sot, as mot  
e dije,  
po të të kishte pasë atë çast pranë,  
do të të jepte një shuplakë të rëndë,  
sa të të nxirrnin sytë xixa,  
se për këtë socializëm ai ka ngrënë edhe  
hekur me dhëmbë...

VIOLINISTES MALËSORË  
PA DASHURINË E SAJ

Pesha e kohës,  
siç provon qëndresën e lidhjeve të çeliqueve,  
provon dhe qëndresën e dashurive.

Sot që mbarova shkollën,  
e nesërmja m'u shfaq në vizionin e gjelbër  
të fshatit tim malësor.

Ajo s'e deshi këtë fshat,  
po fshati janë prindërit e mi, vazhdim i tyre unë.

E pata tepër të vështirë, po nuk ngurova.  
Braktisa një dashuri dritëshkurtër,  
dashuri sakate, pa këmbë e krahë,  
për fshatin tim  
që në krahërorin e tij rritë dashuritë  
e vërteta të mëdha.

## VIOLINISTES MALËSORE

A të kujtohet kur u nise?  
Të gjithë bashkëfshatarët kishin dalë të të  
përcillnin  
të mallëngjyer e të gëzuar se ti do të bëheshe  
artiste.

Nga qielli i rimtë varej një re e vogël, e  
bardhë,  
sikur ta dhuronte vendlindja  
grykëses së shkollës për t'ia bërë jakë.

Edhe sot kanë dalë të gjithë të të presin,  
mirënjohës se ua mbajte fjalën e dhënë,  
krenarë se të kanë çikën e tyre.

Në mbrëmje do të vënë në mes të fshatit  
të këndosh me violinën tënde;  
në këngën tënde mbështetur mbi supet e  
bjeshkëve,







## TEK VARREZAT E DËSHMORËVE

Vijmë këtu të çmallemi me ju, shokë të rënë,  
ne të rinjtë shkollarë,  
që ju kemi njohur vetëm në këngë.

Ju sikur na merrni për dore e na fusni nëpër  
ditët tuaja,  
me barkun petë nga uria,  
me gjoksin plagë nga torturat.

Ju sikur na merrni për dore  
e na fusni nëpër ditët lavdimëdha partizane,  
këmbëpërgjakur marshimeve,  
mishradjegur betejave.

Vijmë këtu e hyjmë tek njëri tjetri.

Ju jeni të lumtur  
se në zemrat tona e gjeni më të gjallë se kurrë  
prushin e luftës së klasave  
e në fytyrat tona  
vazhdimin e ligjshëm të buzëqeshjeve që jua  
preu në mes plumbi.

SHOKU YNË HERO

(Vite Gani Zaimi)

Shokun na u vonove lotet!

I fortë luftoi në tërë luftë e këngëve për tek ti

Fortuna si një egërsë pjakë i shterran fortaj  
e u plagit.

U llogariti me tërë e kooperativë u këtyre

tani po milet.

Shokun për

U ndien, tani të ketori me tërë se shok

Dyert i lamë vishmonë të hapura

se vjetër

Shokun xaxë për YLLI

## SHOKU YNË HERO

(Ylli Gani Zaimit)

Shumë na u vonove sonte!  
I kemi lëshuar të tëra isot e këngëve për tek ti.

Furtunës si një egërsirë plakë i shteruan forcat  
e u platit.  
Ti fitove mbi të. Tufa e kooperativës u kthye e  
tani po milet.

Kthehu pra!

...

E ndiejmë, tani të kemi më tepër se shok.

Dyert i lëmë gjithmonë të hapura,  
se vjen ti...  
shoku ynë hero, YLLI!

## NDËRSA ANILA FESTON

Ndërsa Anila katërvjeçare feston ditëlindjen,  
mbi qytën e pushkës së babait të saj,  
në një llogore në lartësinë, ku buron Valbona,  
era e akullt e alpeve kokën përplas.

Sikur edhe një çast ta mposhte babain gjumi  
e faqen ta mbështeste mbi tokën e butë,  
pushkët e hasmëve që skërmiten matanë,  
gëzimin së bijës do ia përgjaknin që në buzë.



## MBRËMJE MAJI NË ELBASAN

O ç'mbrëmje e ëmbël maji,  
kjo që u ul sonte mbi supet e selvive  
e mbi petalet e bukura të karakaftëve,  
Elbasan!

Tek portë e kalasë kanë dalë prapë kumriat  
krahëbardha,  
të përcjellin ditën e sotme  
e rreth gushë t'i varin një gjerdan me këngët  
e tyre të rralla.

Kashta e Kumtrit e Arusha e Madhe,  
fëmijëve iu dukën si stërkala çeliku të shkrirë,  
që në hapësirë  
flladi i majit i mban pezull.

## GJARPËR ME SHTATË KRERË

Gjarpër me shtatë krerë,  
(dorë e fshehur e armiqve të kobshëm)  
në emër të zotit e të zakonit të maleve,  
zemrat malësorëve ua hëngre  
me dhëmbët e njëri-tjetrit.

Sot që t'i kemi prerë të shtatë krerët,  
i dëgjojmë më qartë se kurrë klithmat e  
kullave të shumta,  
që në shekuj dyert ua mbylle me gardh  
ferrash.

S'ti bëjmë hallall kurrë jetët që na more,  
kokëprera nga duart tona,  
hasmëri.

## L A R G I M I

Një muaj rresht  
këtu punuam e hodhëm shtatin e pritës.

Tani po largohemi.  
Si krahë të kaltër zogjsh  
tenden në erë  
shamitë tona të aksionit,  
sikur shkruajnë në hapësirë  
fjalët më të ngrohita të lamtumirës.

Po largohemi. Vrullin, gjallërinë,  
gëzimet, të qeshurat e këngët tona  
i presin kantieret e tjera.





## VËNDIMI YNË SUBLIM

Na sulej hasmi i veshur me zjarr e çelik,  
në shkretëtira hiri fshatrat na i kthente.

Krojet e pusët shteronin,  
i pinte urrejtja e tokës për armiqtë.

Nga rënkimet e truallit nën këmbën e huaj  
nëpër arat tona djerr mbinin ferrat.  
si mallkim.

... E ne nëpër male

pritë më pritë rendnim:

— Ja të vdesim, ja të rrojmë për LIRI!

... Vendimi ynë sublim.

## HAXHI GASHIT

Ç'kaherë s'të kemi parë as ne, as bjeshkët,  
në ballin tonë e të bjeshkëve është thelluar  
një rrudhë malli.

Veç për ditë  
ta dëgjojmë zërin tek këndon e oshëtin  
luginave e qafave.

«Mos m'i lidhni sytë me shami,  
flakën e pushkëve dua ta shoh me sy,  
se s'jam turk rritë n'Anadoll,  
jam shqiptar rritë në Shqipëri».

...

Dy lisa bjeshke janë rritë mbi varrin tënd,  
ti vetë lis bjeshke,  
rrënjët hedhur nëpër zemra e këngë.

## SHËTITORJA E KANTIERIT

Kjo është rruga e vetme e kantierit tonë.  
Gjithë ditën mbi ballin e gjerë  
ndien vërshimin e hapave, zërave,  
vërshimin e këngëve me ritmet e punës sonë  
e nga pesha e makinave të ngarkuara i dridhen  
tëmthat.

Në mbrëmje,  
e shkruftuar në ngrohtësinë e të qeshurave  
e të bisedave tona  
tek shëtisim pas pune,  
e shkruftuar në ngrohtësinë e gëzimeve tona,  
shpin trupin e tendosur nga dita.



## M A L L I

*(Letrat e një malësori dërguar në-  
nës së tij nga burgjet e Turqisë, ku  
e kishin syrgjunosur.)*

O nëna ime e mjerë, nëna ime e mirë,  
qyqe fillikat ngelur larg në bjeshkë,  
vijne e shkojnë pranverat, jetën përtërijnë,  
veç gëzimit tënd s'i blerojnë një gjeth.

Në dritare të burgut vjen hëna për natë,  
e hollë, e verdhë si një flegër ftoi,  
unë e pyes për ty, ajo s'thotë një fjalë,  
qafën e theftë në një breg përroi.

O nëna ime e mirë, nëna ime trime,  
ç'më gëzove sonte, paske dalë komite.

Mos e lerë të ftohet tytën e pushkës,  
zjarre sa për dy i duhet të ndezë!



O nëna ime trime, komite burrneshë,  
të gjithë djemtë që sot burrërohen malit,  
në vendin tim do t'i keshë!

M A L L I

Illegible mirrored text, likely bleed-through from the reverse side of the page.

O nëna ime e mjerë, nëna ime e mirë,  
qyrtë lullikë meqenëse jeni nënë,  
vijnë e shkojnë prapëprapë, jeta përjetë,  
vetë gjatë këndit të detyrës në gjatë.

Me ditën të ditës, vjen kënaqësi,  
e bëjnë e vërshë si një lëvizje të fortë,  
në të parën për të, në të dytën në të tretën,  
për të tretën në të katërtën.

O nëna ime e mjerë, nëna ime trime,  
e më gëzove s'është paske dhe kënaqësi.

Sho e lere të llohet vërtet e pashkëlqyer,  
këtë të për të i dritë të mjetit!

## LIRIKË PËR ARDHJEN E PRANVERËS

Sythet e tërfilit, të luleve e të barit të njomë,  
pinë ujërat e borës.  
Në verë tërfili e bari do të jenë qumështorë  
për dhentë,  
lulet të bukura për t'i bërë kurorë  
e tufa.

Zogjtë si shpërthimi i parë i gëzimit  
pranveror  
dolën nga të çarat e gurëve e të pemëve;  
nga majëtelat e telefonëve  
ardhjen e stinës së dashur e përshëndetën me  
cicërima gazmore.

Lumenjtë e fryrë  
u derdhën më vrullshëm në turbina,

në mbrëmje më shumë drita patëm në  
dhoma.  
Vajzat e dashuruara u bënë më ëndërrimtare,  
djemtë erdhën në takime më të gëzuar, po më  
seriozë.



## PASQYRA E LËNDËS

Për nënën .....	3
Mbrëmja e fundit .....	4
Malet me blerim mbuluar .....	5
Balada e fëminisë .....	7
Mjeshtri plak i urave .....	8
Fyelli .....	9
Rritja .....	10
Motiv i gëzueshëm .....	11
Natë dhjetori .....	12
Impresion .....	14
Gëzim .....	15
Bujkeshat malësore .....	16
Në sallën e Teatrit të Operas dhe Baletit .....	17
Traktorët .....	18
Çdo fjalë .....	19
Me prillin që po vinte .....	20
Në bllokun e mollëve .....	21
Mbrëmja e parë në Jezercë .....	22
Çika e malësisë .....	23
Marshi i poezisë së vërtetë .....	24
Vendi i bukurisë .....	25
Përgjigje .....	27
Pa dashurinë e saj .....	29



Violinistes malësore .....	30
Tek varrezat e dëshmorëve .....	32
Shoku ynë hero .....	34
Ndërsa Anila feston .....	35
Mbrëmje maji në Elbasan .....	36
Gjarpër me shtatë krerë .....	37
Largimi .....	38
Heroike .....	39
Vendimi ynë sublim .....	40
Haxhi Gashit .....	41
Shëtitorja e kantierit .....	42
Malli .....	43
Lirikë për ardhjen e pranverës .....	45